



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME KORÇË

Nr. 38 prot.

Korçë më 24.01.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Drejtuar : Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 759, datë 30.9.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, Përberjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional, dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", .

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësues të Teorisë dhe/ose Praktikës Profesionale me kohë të plotë, për "Degën Hoteleri - Turizëm".

1.Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësues të teorisë dhe/ose praktikës profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- m) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- n) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- o) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- p) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e posaçme si vijon:

- g) Të ketë diplomë Përkatese niveli Master profesional ose të barazvlefshëm me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- h) Të ketë të paktën 1 (një) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

4. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :
- a) Letër motivimi për pozicionin;
 - b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi
 - c) Kartën e identitetit,
 - d) Diplomën
 - e) Librezën e punës
 - ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
 - f) Çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
 - gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
 - h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
 - d) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit të AFP-së brenda datës.....05.02.2025

TATIANA MERO
DREJTOR I SHKOLLËS

